



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Kryesia e Kuvendit

P-090

Prishtinë, më 15 maj 2017, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 15 MAJ 2017

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviq dhe Danush Ademi, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyçi dhe Valmir Klaiqi;

Nga Administrata e Kuvendit: Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 3 dhe 5 maj 2017,
2. Kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme për mbulimin e shpenzimeve të një dreke zyrtare të shtruar në Prishtinë, më 25 prill 2017,
3. Kërkesa e ish-deputetit të Kuvendit të Kosovës, z. Xhezair Murati, për mbështetje financiare,
4. Të ndryshme.

* * *

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 3 dhe 5 maj 2017

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 3 dhe 5 maj 2017.

2. Kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme për mbulimin e shpenzimeve të një dreke zyrtare të shtruar në Prishtinë, më 25 prill 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

Miratohet raporti i Komisionit për Punë të Jashtme për mbulimin e shpenzimeve të një dreke zyrtare të shtruar në Prishtinë, më 25 prill 2017, në shumën prej 446,50 euro, sipas faturës së bashkëngjitur.

3. Kërkesa e ish-deputetit të Kuvendit të Kosovës, z. Xhezair Murati për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Miratohet kërkesa e ish-deputetit të Kuvendit të Kosovës, z. Xhezair Murati, për mbështetje financiare në shumën prej 5 000 € që i ka shpenzuar për shërim jashtë vendit.
2. Mjetet e parapara nga pika një (1) e këtij vendim paguhen nga kategoria ekonomike “subvencione dhe transfere” dhe të derdhen në llogarinë bankare ProCredit Bank, me nr. XK0501120129964000111.

4. Të ndryshme

4.1 Paga kalimtare e deputetëve të Kuvendit të Legjislaturës V

Kryesia, pas diskutimit lidhur me pagën kalimtare të deputetëve të Kuvendit të Legjislaturës V, mori këtë:

VENDIM

1. Kompensimi kalimtar i pagës bazë të deputetit të Legjislaturës V të Kuvendit të Republikës së Kosovës, shpërndarë me Dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. DV-001-2017, datë 10 maj 2017, me përjashtim të nënkryetarëve të Kuvendit, fillon nga data 11 maj 2017 deri më 10 maj 2018.
2. E drejta e deputetit, nga pika 1 e këtij vendimi, nuk i takon nëse realizon të hyra financiare nga ndonjë burim tjetër ose nëse kthehet në vendin e punës, të cilin e ka pasur para zgjedhjes deputet, ose në vend tjetër të përshtatshëm për të.

4.2 Mbushje e telefonave celularë për deputetët e Kuvendit të Legjislaturës V

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me mbushjet e telefonave celular, mori këtë:

VENDIM

Deputetëve të Legjislaturës V të Kuvendit të Republikës së Kosovës e drejta për mbushje të telefonave celular u përfundon më 31 maj 2017.

4.3 Statusi i stafit mbështetës politik të grupeve parlamentare

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me statusin e stafit mbështetës politik të grupeve parlamentare, mori këtë:

VENDIM

Statusi i stafit mbështetës politik të grupeve parlamentare vazhdohet deri më 31 maj 2017.

4.4. Udhëtimet zyrtare jashtë vendit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me udhëtimet zyrtare jashtë vendit, mori këtë:

VENDIM

Të gjitha udhëtimet zyrtare që u janë lejuar deputetëve të Kuvendit dhe komisioneve parlamentare anulohen, ngase ka përfunduar mandati i Kuvendit, me përjashtim të delegacionit të përhershëm.

4.5 Kthimi i kartelave të votimit të deputetëve

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kthimin e kartelave të votimit, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Kërkohej nga deputetët e Legjislaturës V të Kuvendit të Republikës së Kosovës që t'i kthejnë kartelat e votimit në Shërbimin e Deputetëve.

4.6 Shfrytëzimi i zyrave nga grupet parlamentare dhe komisionet parlamentare

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me shfrytëzimin e zyrave nga ana e grupeve dhe komisioneve parlamentare, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Grupeve parlamentare dhe komisioneve parlamentare të Legjislaturës V të Kuvendit të Republikës së Kosovës, zyrat e punës në hapësirat e ndërtesës së Kuvendit u lihen në shfrytëzim deri më 31 maj 2017.

4.7 Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, z. Xhavit Haliti

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

Miratohej kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, z. Xhavit Haliti, që dy shoqërueseve të tij (policë për mbrojtje nga afër) Mirsad Hasani (i lindur më 19. 6. 1977, ID 1019695715) dhe Mentor Krasniqi (i lindur më 20. 4. 1972, ID 2004289547), të caktuar nga organi kompetent i sigurisë, t'u bëhet pagesa e shujtës ditore në shumën prej 5 euro në ditë.

4.8 Kërkesa e kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, z. Haxhi Shala

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

Miratohet kërkesa e kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, z. Haxhi Shala, t'i mbulohen shpenzimet e biletës së udhëtimit në relacionin Bruksel-Prishtinë për datën 21 mars 2017, sipas faturës së bashkëngjitur.

4.9 Kërkesa e kryetarit të GP të AAK-së, Pal Lekaj

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

Miratohet kërkesa e kryetarit të GP të AAK-së, Pal Lekaj, për mbulimin e shpenzimeve të taksisë nga Aeroporti në Strasburg, në shumë prej 250 euro.

4.10 Raporti i shpenzimeve për pjesëmarrja në punimet e Sesionit të Rregullt II të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE), Strasburg (Francë), 23-28 prill 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Miratohet raporti i shpenzimeve, në shumën 2 001,46 euro për blerjen e pajisjeve të zyrës së delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, sipas kërkesës dhe faturave të bashkëngjitura.
2. Miratohet raporti i shpenzimeve për qëndrimin e anëtarëve të delegacionit në punimet e Sesionit të Rregullt II të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE), Strasburg (Francë), 23-28 prill 2017, sipas kërkesës dhe faturave të bashkëngjitura.
3. Mjetet nga pika 1 e këtij vendimi barten në xhirollogarinë e koordinatores së Njësisë për Marrëdhënie Ndërkombëtare, znj. Ariana Musliu-Shoshi.

4.11 Kërkesa e Institutit Kombëtar i Integritit të Jetimëve Shqiptarë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohet kërkesa e Institutit Kombëtar të Integritit të Jetimeve Shqiptarë që t'u lejohet salla e Kuvendit për mbajtjen e takimit të fëmijëve jetimë më 20 maj 2017.

4.12 Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2017

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me raportin e shpenzimeve të Kuvendit për tremujorin e parë të vitit 2017, mori këtë:

VENDIM

Autorizohet Administrata e Kuvendit që raportin e shpenzimeve të Kuvendit për tremujorin e parë të vitit 2017 ta publikojë në ueb-faqen e Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale